

FONDI SHOIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 08.04.2016]

Për: Operatorin ekonomik “ANK” sh.p.k (NIPT J92408001N).

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt : **“Ndertimi i rruges “Dhimiter Konomi” (mbi Rrap), Vlore”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertimi i rruges “Dhimiter Konomi” (mbi Rrap), Vlore”.**

Kohëzgjatja: **brënda 14 muajsh nga data e fillimit te punimeve.**

Fondi limit: **408.175.256 (katerqind e tete milion e njeqind e shtatedhete e pese mije e dyqind e pesedhete e gjashte) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 27.01.2016.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

	SHOQERIA	OFERTA
1	CAUSHI/M	261,521,000
2	RSM Company	276,464,422
3	COMPANY RIVIERA 2008	280,575,438
4	CURRI	290,957,430
5	RIVIERA	325,102,100
6	ALBA KONSTRUKSION	327,613,890
7	B-93	335,597,220
8	Tirrena Scavi S.p.A.	336,635,315
9	ARIFAJ	348,924,499
10	Victoria Invest International	360,087,983
11	A. N. K.	364,625,890
12	ALB - STAR	365,225,026
13	ALKO-IMPEX General Construcion	366,500,600
14	GENER 2	375,977,276
15	T.T.A ALBA LAM	388,623,101
16	SENKA/L	400,000,000
17	ROSI	PA OFERTE

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

“Caushi” shpk (49%), “Shkelqimi-07” shpk (36.6%), dhe “Sinder AB” shpk (14.4%) per arsye se:

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit duhet te mos jete me e vogel se 350.000.000 leke pa tvsh. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku vlera te mos jete me e vogel se vlera e fondit limit” pasi xhiron mesatare e ka 163.486.943 leke, ndersa sipas perqindjes (49%) i takon ta kete 171.500.000 leke.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te disponoje vlera te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave” pasi ka gjendje ne banke 128.000 euro = 17.920.000 leke, ndersa sipas perqindjes (49%) i takon te kete 20.000.587 leke.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.4.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve per periudhen Janar 2015 deri Tetor 2015 te jete jo me pak se 100 (njqind) punonjës në muaj. Ne kete numer perfshihet dhe stafi drejtues. Kjo te deshmohet me vërtetim nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar dhe te shoqerohet me formularet E-SIG pasi sipas perqindjes (49%) i takon te kete minimalisht 49 punonjes ne muaj, nderkohe qe vetem per muajt gusht, shtator dhe tetor e ploteson kete kusht.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.4.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te disponoje certifikatat:

ISO 9001:2008

ISO 14001:2004

OHSAS 18001:2007

ISO 39001:2012

Certifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit” pasi certifikatat ISO 9001:2008 dhe ISO 39001:2012 jane ne emer te “Caushi/M” dhe jo te “Caushi”.

Shoqeria “Shkelqimi-07” shpk nuk ploteson piken 2 te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim pasi ka detyrim per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore ne shumen 1.500.000 leke dhe eshte ne proces apelimi.

Shoqeria “Shkelqimi-07” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit” pasi pasi per te vertetuar plotesimin e ketij kushti ka paraqitur dy pune:

Rruga Gege Frasher” gjate tre viteve te fundit ka realizuar 20.138.815 leke punime pa tvsh (nga faturat tatimore).

Rruga Polovine Gege” me vlere pa tvsh 72.217.609 leke (sipas formularit te vleresimit).

Sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper (36.6%) i takon te paraqese dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 74.696.072 leke pa tvsh ose disa pune me vlere te perbashket pa tvsh jo me pak se 298.784.287 leke. Me punet e paraqitura nuk e ploteson kete kusht.

“RSM Company” shpk (55%), “Aurora Konstruksion” shpk (25%), dhe “Egland” shpk (20%) per arsye se:

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit duhet te mos jete me e vogel se 350.000.000 leke pa tvsh. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku vlera te mos jete me e vogel se vlera e fondit limit”* pasi nuk ka paraqitur vertetimin per xhiron.

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet”* pasi nuk ka paraqitur dokument per shlyerjen e detyrimeve per taksat vendore ne Tirane, ku ushtron aktivitet qe nga data 18.11.2015.

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e nje inxhinieri hidroteknik dhe nje inxhinieri gjeolog, te domosdoshem per kryerjen e punimeve qe ka marre persiper sipas marreveshjes se bashkepunimit.

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson piken 2.4.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.4.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera”* pasi ka deklaruar vetem per arkitekt Daut Retkoceri dhe ing mekanik Ragip Shahini dhe jo per inxhinieret e tjere.

Shoqeria “Aurora Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”* pasi ka paraqitur punen “Ndertim kanali i ujrave te larta Berat” por vlera e punes se realizuar pa tvsh eshte 29.667.155 leke, nderkohe qe sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune me vlere jo me te vogel se 51.021.907 leke pa tvsh.

Shoqeria “Egland” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te disponoje vlera te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave”* pasi bazuar ne marreveshjen e bashkepunimit, ne perputhje me perqindjen e punes qe ka marre persiper (20%) duhet te paraqiste dokumentacion per disponimin e nje shume prej jo me pak se 8.163.505 leke, nderkohe qe sipas dokumentacionit te paraqitur rezulton se ka vetem 1.554.386 leke.

Shoqeria “Egland” shpk nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet”* pasi nuk ka paraqitur vertetimin e per pagesen e taksave lokale ne Komunen Clirim ne Kolonje, komune ne te cilen ka kryer punen e ngjashme te realizuar gjate vitit 2015 dhe te deklaruar ne tender, me vlere 19.827.198 leke me tvsh.

“Company Riviera 2008” shpk (27.7%), “Kevin Konstruksion” shpk (47.8%), dhe “Ndrekaj” shpk (24.5%) per arsye se:

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.1.dh te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaraten mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9. Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”* pasi per objektin e deklaruar “Ndertim i kampusit te ri Universitar “Aleksander Moisiu” Durres me vlere 568.116.276 leke me tvsh, ne te cilin shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk ka kryer 60% te punimeve, mungon marreveshja e bashkepunimit per te percaktuar se cilat punime jane kryer nga shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk. Punimet e rikonstruksionit te korpusit Universitar jane kryesisht rikonstruksion godinash dhe nuk mund te konsiderohen si punime te ngjashme me punimet objekt i ketij prokurimi.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates....”* pasi ka paraqitur dokumentacion per disponimin vetem te nje kamioni. Shoqeria “Ndrekaj” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete...”* pasi drejtuesi teknik ing Perparim Likaj eshte i dypunesuar ne kundershtim me piken 2 te Kreut IV te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* pasi ka lidhur kontraten e punesimit te dates 28.12.2015 me shoqerine “T.T.A Alba – Lam” shpk.

“Curri” shpk (60%) dhe “Be - Is” shpk (40%) per arsye se:

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi per inxhinierin hidroteknik Faik Curri, inxhinierin gjeolog Elsa Doda (Veseli) dhe inxhinierin e mjedisit Arben Lici ka paraqitur CV te pa firmosura. Keta inxhinierë jane te domosdoshem per kryerjen e punimeve qe ka marre persiper sipas marreveshjes se bashkepunimit. Per kete pike Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mbeshtet ne vendimin 1524 date 22.09.2015 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Bashkimi i shoqerive nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi shoqeria “Curri” shpk nuk ka arkitekt ne stafin e vet, ndersa shoqeria “Be – Is” shpk per arkitektin Glodian Dauti ka paraqitur nje CV te pa firmosur nga arkitekti. Per kete pike Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mbeshtet ne vendimin 1524 date 22.09.2015 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson piken 2.4.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera”* pasi nuk e ka paraqitur deklaraten e kerkuar.

Shoqeria “Be - Is” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë*

jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. Nuk ploteson me nje pune te vetme pasi puna me e madhe ne 3 vitet e fundit ka vleren 60.413.454 leke pa tvsh nga 81.635.051 qe duhet ta kete. Po ashtu vlera totale e puneve te ngjashme ne 3 vitet e fundit eshte 295.582.455 leke nga 326.540.205 leke pa tvsh qe duhet ta kete sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper. Nuk jane marre parasysh ne llogaritje punet e realizuara perpara tre vjecarit te fundit dhe puna “Rikualifikim urban i dy shesheve Tirane” per te cilen jane paraqitur faturat e leshuara nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk dhe nuk eshte paraqitur asnje fature tatimore qe te vertetoje se shoqeria “Be – Is” shpk ka kryer pjese te kesaj pune. Te dhenat u permbledhen ne nje tablele.

“Riviera” shpk (51%) dhe “Kostruttiva” shpk (49%) per arsye se:

Shoqeria “Kostruttiva” shpk nuk ploteson piken 2 te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim pasi vertetimi i leshuar nga Agenzia Entrate mban daten 14 shtator 2015, pra eshte pertej afatit tre mujor te vlefshmerise.

Shoqeria “Kostruttiva” nuk ploteson kerkesen 2.1.e te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit lidhur me likuidimin e detyrimeve te OSHEE pasi nuk ka paraqitur vertetimin e kerkuar. Per te provuar likuidimin e detyrimeve ka paraqitur nje libreze (qe nuk kuptohet se kujt i perket), nje kontrate nenqeraje me zotin Trojan Pavllofski dhe nje vertetim nga OSHEE qe zoti Trojan Pavllofski nuk rezulton debitor ndaj OSHEE. Keto dokumenta nuk provojne qe shoqeri “Kostruttiva” nuk ka detyrime ndj OSHEE.

Shoqeria “Kostruttiva” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit duhet te mos jete me e vogel se 350.000.000 leke pa tvsh. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vertetim nga Dega e Tatim Taksave per xhiron vjetore te realizuar ne 3 (tre) vitet e fundit ku vlera te mos jete me e vogel se vlera e fondit limit” pasi nuk ka paraqitur vertetim per xhiron e realizuar.

Shoqeria “Kostruttiva” shpk nuk ploteson piken 2.4.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e licensave, pasi mungon pika e licenses NS 18 “Punime topogjeodezike”, e domosdoshme per te realizuar punimet qe ka marre persiper kjo shoqeri sipas marreveshjes se bashkepunimit.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson piken 2 te Kerkesave te Pergjithshme te Kualifikimit pasi ka paraqitur vertetimin e leshuar nga Drejtoria Tatimore Tirane, ne te cilin, nder te tjera citohet: “... rezulton se per periudhen deri ne date 08.01.2016, nuk ka detyrime tatimore ne tvsh, tatim fitimi, tatim mbi te ardhurat personale, sigurime shoqerore e shendetesore dhe tatim ne burim, por vetem gjoba dhe interesa per te cilat ka lidhur aktmarreveshje per pagesat me keste...”. Ne kete menyre, duke qene se ky subjekt pervec gjobave ka edhe interesa te pa paguar, nuk ploteson kete kerkese per kualifikim.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. Per te provuar plotesimin e ketij kushti shoqeria “Riviera” shpk ka paraqitur nje kontrate te lidhur me Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit ne Kosove, nenshkruar ne daten 27.07.2009, me objekt: “Zgjerimi i rruges nacionale M2 segmenti rrugor prishtine –

udhekryqi M2 R120 (Millosheve), Loti 4”. Kontrata nuk eshte e plote, pasi mungojne te gjithë anekset e kontrates. Ne kete kontrate punimet merren persiper te zbatohen nga bashkimi i shoqerive “Riviera” shpk (50%) dhe “Toni Com” (50%). Per kete kontrate jane paraqitur edhe tre fatura: fatura nr 2112001 date 21.12.2012 me vlere 313.024,16 Euro pa tvsh, fatura nr 2012001 date 20.12.2012 me vlere 298.312,70 Euro pa tvsh dhe fatura nr. 2312002 date 22.12.2015 me vlere 238.844.09 euro pa tvsh. Duke qene se ne kerkesat per kualifikim kerkohen pune te kryera ne tre vitet e fundit, rezulton se vetem punet e faturuara me faturen nr. 2312002 date 22.12.2015 me vlere 238.844.09 euro pa tvsh jane realizuar ne periudhen e kerkuar. Duke qene se shoqeria “Riviera” shpk ka kryer vetem 50% te ketyre puneve, vlere e punes se realizuar prej saj eshte rreth 16.719.080 leke pa tvsh nderkohe qe duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme ne masen 204.087.628 leke pa tvsh ne nje pune te vetme.

“Alba Konstruksion” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi:

Per inxhinierin e ndertimit Genci Xhafa dhe per arkitektin Daniel Gjoni ka paraqitur nje cv te pa firmosur. Per kete pike Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mbeshtet ne vendimin 1524 date 22.09.2015 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Mungon diploma e inxhinieres elektrike Katerina Dhoska. Ne vend te saj eshte paraqitur nje diplome e ing. Luljeta Thomaj dhe nuk eshte paraqitur asnje dokument qe te provoje se eshte i njejti person

Drejtuesit teknike Merkur Kamo (inxhinier hidroteknik), Katerina Dhoska (inxhinier elektrike), Xhemil Gurabardhi (inxhinier mekanik) dhe Najada Jarazi (inxhinier mjedisi) jane te punesuar part time ne kete shoqeri me vetem 32 ore ne muaj. Po ashtu drejtuesi teknik Bajram Cika (inxhinier gjeolog) eshte i punesuar part time ne kete shoqeri (vetem 12 ore ne muaj). Ky fakt eshte ne kundërshtim me Kreun IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë”, pika 2 “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit”, te VKM Nr.42, datë 16.1.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** ku nder te tjera citohet: *“Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”*. Fakti qe drejtuesit teknike nuk mund te jene te punesuar part time gjen mbeshtetje edhe ne Kreun III, pika 3, germa “c” te VKM Nr.42, datë 16.1.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** ku nder te tjera citohet: *“Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”*.

Nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”*. Nuk ploteson

me nje pune te vetme pasi puna me e madhe (e deklaruar ne tender) ne 3 vitet e fundit ka vleren 120.400.293 leke pa tvsh nga 204,087,628 qe duhet ta kete. Po ashtu vlere totale e puneve te ngjashme ne 3 vitet e fundit (e deklaruar ne tender) eshte 272,507,911 leke nga 816.350.512 leke pa tvsh qe duhet te kete per te plotesuar kushtin. Ne vleresim (bazuar ne faturat tatimore te paraqitura) jane marre ne konsiderate punet e kryera gjate tre viteve te fundit janar 2014 deri janar 2016.

“B - 93” shpk (49%) dhe “Gjiguria” shpk (51%) per arsye se:

Shoqeria “Gjiguria” shpk nuk ploteson piken 2 te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim pasi ka detyrime ne tatimin mbi vleren e shtuar ne shumen 53.301.042 leke dhe eshte ne proces gjyqesor.

Shoqeria “Gjiguria” shpk nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet”* pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e taksave vendore ne Vlore, Himare, Sarande, ku ushtron aktivitet bazuar ne ekstraktin e QKR.

“Tirrena Scavi” spa per arsye se:

Perfaqesuesi ligjor i deges se shoqerise “Tirrena Scavi” ne shqiperi zoti Moren Dakoli ka leshuar nje autorizim per zotin Damiano Marco Corda qe ky i fundit te firmose dokumentat e tenderit. Dokumenti nuk eshte hartuar para noterit ne formen e nje prokure te posacme, dhe, si i tille, eshte i pavlefshem.

Nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit *“Operatori Ekonomik duhet te disponoje vlere te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave”* pasi vertetimi i leshuar nga Veneto Bank citon qe *“bazuar ne njohurite dhe vleresimet tona kjo shoqeri mund te kete aksese ne fonde ne vleren all 40.817.525,6 leke”* dhe nuk shprehet qe e disponon kete shume.

Nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet”* pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e taksave vendore ne qytetin e Durresit ku ushtron aktivitet (ka seline) bazuar ne ekstraktin e QKR.

Nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin, pasi mungon inxhinieri topograf (gjeodet) ne staf. Per te plotesuar kete pozicion ka paraqitur dokumentacion per ing Halasz Gyorgyo i cili, nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton te jete inxhinier ndertimi i specializuar ne hekurudha, rruge dhe ura.

Nuk ploteson piken 2.4.8 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me certifikatat ISO, pasi nga kontrolli ne faqen perkatese te internetit te shoqerise qe ka leshuar certifikatat ISO rezulton se ato jane te pavlefshme (cancelled).

Nuk ploteson piken 2.4.8 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me licensat qe duhet te disponoje Operatori Ekonomik, pasi licensa eshte e palexueshme. Per kete pike komisioni u mbeshtet ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik Nr 1868 date 11.12.2015 ku citohet: *“III.1.8. Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik ankimes në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor për gjendjen e fuqisë punëtore, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të theksojë sërish faktin se dokumentacioni i hedhur në sistemin e prokurimeve elektronike është i paqartë, i palexueshëm dhe i pa identifikueshëm, për të parë përputhshmërinë e tij me kriterin e përcaktuar në dokumentat e*

tenderit nga autoriteti kontraktor me qëllim krijimin e një panorame të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.

1. III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik sa më sipër analizuar, konstaton se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterëve të sipërpermendura, në tërësinë e tij është i paqartë, i palexueshëm dhe i pakuptueshëm.

2. III.1.10. KPP sqaron se në nenin 63, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së”.

3. Në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 6454 prot., datë 30.05.2013 përcaktohet se: “Duke marrë shkas nga problemet e hasura nga Operatorët Ekonomikë gjatë procesit të ngarkimit të dokumentave në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Agjencia e Prokurimit Publik sugjeron që skanimi i dokumentave të bëra në format .pdf, të bëhet me rezolucion më të ulët se 75 dpi.

4. Gjithashtu rekomandojmë që Operatorët Ekonomikë që ofertojnë në procedurat me vlerë më të lartë se 400.000 lekë, të ulin në maksimum numrin e file-ve, duke i grupuar ato në sa më pak dokumenta për të lehtësuar upload-imin e ofertës”.

5. Në manualin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik për operatorët ekonomikë është përcaktuar se: “[...] Para se të filloni me ngarkimin e dokumenteve, duhet të siguroheni që të gjithë dokumentet të jenë të konvertuara në mënyrë elektronike në kompjuterin tuaj[...] Materialet e ngarkuara në sistem duhet të jenë në formatin .pdf [...]” 12

6.

7. III.1.11. Sa më sipër, sqarojmë se është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik për paraqitjen dhe hedhjen e dokumentacionit të plotë, të saktë e të qartë për nga mënyra e leximit dhe identifikimit të të dhënave të tij, në mënyrë që të jetë i lexueshëm dhe për të verifikuar nëse ai është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Gjithashtu KPP sqaron se nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1 e lpp në të cilin përcaktohet se “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”, pasi sqarimet mund të kërkohej vetëm në rast se autoriteti kontraktor e shikon të nevojshme dhe arsyeshme për vërtetësinë e dokumentacionit dhe jo në rastin konkret kur i gjithë dokumentacioni për përmbushjen e kriterit të punonjësve dhe makinerive i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për shkak të këtij të fundit, është i paqartë dhe rrjedhimisht i pavlerësueshëm nga ana e KPP”.

“Arifaj” shpk (48.6%%), “Denisi 05” shpk (34.9%), dhe “Xhast” shpk (16.5%) per arsye se: Marreveshja e bashkepunimit ndermjet shoqerive eshte lidhur ne kundershtim me rregullat e parashikuara ne aktet ligjore per prokurimin publik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni konstaton se në këtë kontrate nuk është bërë ndarja e elementëve konkretë të punimeve për secilin prej anëtarëve të bashkimit në përputhje me përcaktimet ligjore. Gjithashtu referur ofertës dhe preventivit të ofertës të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk rezulton të jenë parashikuar në mënyrë të detajuar elementët konkretë të punimeve/zërave që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, duke krijuar paqartësi në lidhje me

përgjegjësitë konkrete që do të ketë secili prej tyre në realizimin e kësaj kontrate. Referuar nenit 74 pika 1 të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Komisioni gjykon se ndarja e elementëve konkretë të zërave të punimeve e parashikuar në mënyrë eksplicite në aktet ligjore sa më sipër, ka rëndësi thelbësore si për autoritetin kontraktor ashtu edhe për operatorët ekonomikë pasi lidhet drejtpërdrejtë me evidentimin e përgjegjësisë që do të marrë secili prej anëtarëve të bashkimit në realizimin e objektit të prokurimit e njëherazi lidhet ngushtë me plotësimin e kapaciteteve teknike/profesionale nga secili prej anëtarëve të bashkimit në proporcion pikërisht me punën/punët konkrete që kanë marrë përsipër të realizojnë. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se oferta e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe kontrata e bashkimit të përkohëshëm të shoqërive nuk përmbush një prej kushteve kryesore të parashikuar nga VKM 914/2014. Per kete vendim komisioni ju referua vendimit te KPP nr 42 date 15.01.2016 ne te cilin shqyrtohet nje rast analog.

Shoqeria “Arifaj” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi per inxhinierin hidroteknik Viktor Papa, inxhinierin elektrik Blenard Agushi dhe inxhinier mekanik Edmir Cerkezi ka paraqitur CV te pa firmosura. Per kete pike Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mbeshtet ne vendimin 1524 date 22.09.2015 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Shoqeria “Arifaj” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi nuk ka paraqitur cv per arkitektin. Shoqeria “Denisi 05” shpk nuk ploteson piken 2.4.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve per periudhen Janar 2015 deri Tetor 2015 te jete jo me pak se 100 (njqind) punonjës në muaj. Ne kete numer perfshihet dhe stafi drejtues. Kjo te deshmohet me vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar dhe te shoqerohet me formularet E-SIG”* pasi ne muajin korrik 2015 ka patur 30 punonjes, ne muajin gusht 2015ka patur 27 punonjes dhe ne muajin shtator 2015 ka patur 27 punonjes nga 34 qe duhet te kete sipas perqindjes se bashkepunimit.

Shoqeria “Denisi 05” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e arkitektit dhe inxhinierëve hidroteknik, mekanik dhe gjeolog. Gjithashtu per inxhinierin e ndertimit Kole Precetaj ka paraqitur CV te pa firmosur, per inxhinierin gjeodet Bilbil Kocia mungon diploma, per inxhinierin elektrik Gjon Pjetri mungon diploma, per inxhinieren e mjedisit Enkelejda Arizaj ka paraqitur CV te pa firmosur. Per kete pike Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mbeshtet ne vendimin 1524 date 22.09.2015 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Shoqeria “Xhast” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...”* pasi per inxhinierin e ndertimit (rezident) Artan Peshtani, inxhinierin hidroteknik Omer Llukovi, inxhinieren elektrike Alida Ramaj, inxhinier mekanik Viktor Pernocaj, inxhinierin gjeolog Sali Lleshi, inxhinieren e mjedisit Enkelelda Shkurta dhe per inxhinieren topografe Rudina Kumanova ka paraqitur CV te pa firmosura. Per kete

prike Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mbeshtet ne vendimin 1524 date 22.09.2015 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Shoqeria "Xhast" shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt..." pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per arkitektin. Ne kushtet e mungeses se ndarjes se elementëve konkretë të punimeve për secilin prej anëtarëve të bashkimit në kontratën e bashkepunimit, per tu kualifikuar duhet qe kjo shoqeri te disponoje te gjitha stafin e kerkuar.

"Viktoria Invest International" shpk (55.12%), "Al Asfalt" shpk (25.08%), dhe "Viktoria Invest" shpk (19.8%) per arsye se:

Shoqeria "Viktoria Invest International" nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin, pasi, sipas marreveshjes se bashkepunimit, ka marre persiper punime shtresash rrugore, kanalizime te ujrave te zeza dhe kanalizime te ujrave te bardha dhe nuk ka ne stafin e vet inxhinier mjedisi dhe inxhinier topograf, te domosdoshem per kryerjen e ketyre punimeve.

Shoqeria "Viktoria Invest" shpk nuk ploteson piken 2.4.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit "Sistemim asfaltim rruga Fshat – Gramsh, realizuar nga bashkimi i shoqerive "Viktoria Invest" shpk dhe "Al Mex Wood" shpk. Ne formularin e vleresimit citohet qe shoqeria "Viktoria Invest" shpk ka kryer 90% te punes ndersa shoqeria "Al Mex Wood" shpk ka kryer 10% te punes. Por per kete objekt te gjith faturat tatimore jane leshuar nga shoqeria "Al Mex Wood" dhe nga faturat nuk rezulton qe shoqeria "Viktoria Invest" te kete kryer punime ne kete objekt.

Shoqeria "Al Asfalt" nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin, pasi, sipas marreveshjes se bashkepunimit, ka marre persiper punime ne rrjetin e ujesjellesit dhe nuk ka ne stafin e vet inxhinier hidroteknik, te domosdoshem per kryerjen e ketyre punimeve. Ka paraqitur dokumentacion per ing hidroteknik Drita Hoxha por dokumentacioni nuk eshte i plote pasi mungon diploma.

"Alb Star" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet" pasi nuk ka paraqitur dokument per shlyerjen e detyrimeve per taksat vendore ne Berat, Kucove, Korce Trebinje Podgozjan, Fier, Tirane Vaqarr Vishaj, Elbasan Gostime Shtepanj, Korce Symiz Libonik, Korce Bucimas, Tirane. Ka Paguar Vetem Ne Patos.

"Alko Impex General Construcion" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.4.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit "Rikonstruksion I Rrugës Komsit – Burrel" per te cilen ka paraqitur fatura per punimet e realizuara ne tre vitet e fundit ne shumen 30,300,436 leke pa tvsh, me te cilen nuk ploteson kerkesen per pune te ngjashme. Ka paraqitur gjithashtu punen "Stacioni i autobusave Kosove" per te cilen nuk ka paraqitur faturat tatimore ne perputhje me kerkesen. Me dokumentacionin e paraqitur nuk ploteson kete kerkese per kualifikim.

"T.T.A Alba Lam" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet" pasi nuk ka

paraqitur dokumentacion per shlyerjen e taksave vendore ne Shkoder Malesi e Madhe dhe Lezhe, ku ushtron aktivitet bazuar ne ekstraktin e QKR.

Nuk ploteson piken 2.4.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e puneve sipas tabelës bashkëngjitur procesverbalit.

Puna 1 është kryer ne bashkëpunim me shoqerine "Junik" shpk dhe shoqeria "T.T.A Alba Lam" shpk ka realizuar 60% te punes. Rezulton se nuk permbush kete kerkese pasi ai duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 204,087,628 leke pa tvsh, vlere te cilen nuk e arrin as me te gjitha punet e paraqitura. Po ashtu, per te gjitha punimet shtese nuk ka paraqitur kontrate dhe akt kolaudimi, dhe ne kete menyre nuk mund te merren parasysh. Nuk ploteson piken 2.4.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "*Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera*" pasi nuk e ka paraqitur deklaraten e kerkuar.

"Senka/L" shpk per arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion per kualifikim.

"Rosi" shpk per arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion per kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**ANK**" sh.p.k (NIPT J92408001N) se oferta e paraqitur, me vlerë **364.625.890** (treqind e gjashtedhete e kater milion e gjashteqind e njezet e pese mije e teteqind e nentedhete) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **11.03.2015**.

Ne datën 04.03.2016 paraqiten ankesë shoqerite "Viktoria Invest International" shpk dhe "Riviera" shpk. Ankesave ju kthye përgjigje në datën 04.03.2016 duke i refuzuar ato.

Ne datën 07.03.2016 paraqiti ankesë shoqeria "Curri" shpk. Ankeses ju kthye përgjigje në datën 11.03.2016 duke e refuzuar ate por duke modifikuar arsyet e skualifikimit te kesaj shoqerie.

Ne datën 11.03.2016 shoqeria "Riviera" shpk paraqiti ankesë ne KPP.

Ne datën 08.04.2016 mberriti vendimi i Komisionit te Prokurimit Publik nr. 472 i cili lejon Autoritetin Kontraktor te vazhdoje proceduren e prokurimit